



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dohetari Prilpjen / Prilpdate Received / Received	18.01.2023	3	viti god year
Organi / Njësia Organi / Jednica Org / Unit	503/2023	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK			113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1104/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1104/2022 të datës 06.12.2022, të parashtruar nga me adresë banimi në fshatin në Komunën e Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 17.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1104/2022 e datës 06.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës, më datë 06.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 7694/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos kompensimin me rastin e vdekjes së vëllait.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 13.12.2022 ka proceduar kërkesën për informata nga Thesari i Kosovës lidhur me arsyet e mos kompensimit për ankuesin, mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7694/2022 të datës 06.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Kërkesën e datës 25.05.2022 e parashtruar nga ankuesi për kompensim materiale; Kërkesën për pagesën retroaktive të datës 10.06.2022 e dorëzuar nga Komuna e Podujevës për Thesarin e Kosovës; Vendimin me Nr. 02-120/10-0037836/22 i datës 26.05.2022 i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Podujevës për kompensimin e ankuesit me rastin e

vdekjes së vëllait; Deklaratë e ankuesit e datës 07.07.2022; Certifikatën e vdekjes me Nr. V 10512017 e datës 28.06.2022; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile me Nr. E 26256873 i e datës 28.06.2022; Kërkesë për informata zyrtare e datës 13.12.2022 për Drejtorin e Thesarit të Kosovës; Kërkesën për prove shtesë për ankuesin e datës 16.01.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 17.01.2023 nga ankuesi; Vendimin me Nr. 13-110/06-0042764/22 të datës 09.06.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar së ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesi është i punësuar në Komunën e Podujevës, gjegjësisht i njëjti sipas Akt-it të Emërimit me numër AE.Nr.130192/03-0079904/21 të datës 01.09.2021 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës Përgjegjës për Bibliotekë Komunale, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa më Vendimin me Nr. 13-110/06-0042764/22 të datës 09.06.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës është bërë verifikimi dhe deklarimi i statusit të zyrtarit publikë në kategorinë e nëpunësit të shërbimit civil.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi më datë 25.05.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Podujevës për kompensim me rastin e vdekjes së vëllait. Kryetari i Komunës së Podujevës përmes Vendimit me Nr. 02-120/10-0037836/22 i datës 26.05.2022 ka lejuar kompensimin e mjeteve monetare në vlerën 389.20 Euro me rastin e vdekjes së vëllait të ankuesit, por që ky vendim nuk është ekzekutuar nga Thesari i Kosovës, dhe së i ky i fundit nuk ka ofruar asnjë sqarim lidhur me mos ekzekutimin e vendimit në fjalë.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e bazueshmerisë së pretendimeve ankimor të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: "...2. Nëpunësit civil, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafi 2, ku përcaktohet se: 2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes kompensimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Lidhur me faktin se kush përbënë familjen, Kolegji i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës lidhur me përkufizimin e bashkësisë familjare, ku në nenin 271 përcaktohet se: Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji. Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit thekson faktin së çështja e përkufizimit të familjes sipas dispozitave të Ligjit për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Aktgjykimin A.A.nr.14/2017.

Andaj, mbi bazën e kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas certifikatës me nr. ser. V 10512017 të datës 28.06.2022, ka konstatuar se i ndjeri ka qenë vëlla i ankuesit, dhe meqenëse me asnjë provë nuk dëshmohet së ankuesi ka qenë duke jetuar në bashkësi familjare me të ndjerin apo ka ndarë ekonomi të përbashkët me të, Kolegji vlerëson së pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, është i pa bazuar.

Theksuar si me lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1104/2022

Ilire Shaqiri

[Signature]
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

